



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 15, dt. 15.03.2024

#### ***MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 date 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes të Programit Buxhetor Afatmesëm”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 3 datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, Vendimin e Këshi lit të Qarkut nr.22 datë 22.12.2023 “Mbi miratimin e tavanave përfundimtare dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 për Këshillin e Qarkut”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

### VENDOSI

1. Të miratojë tavanet përgatitore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 sipas tabelës bashkëngjitur:
  - Planin e transfertës së pakushtëzuar
  - Planin e transfertës së kushtëzuar
  - Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Erjon NEXHIPI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi O.Beqiraj  
Juristi Gj. Kristo  
Sek. K.Qarkut B. Maço



## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### Tavanet e të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027

#### TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR KESHILLI I QARKUT

ne 000/ leke

	2024	2025	2026	2027
Trn e pakushtezuar	75200	76244	79378	82511
Trn e pakushtezuar per rritjen e pagave	840	1512	1512	1512
<b>TOTALI</b>	<b>76,040.00</b>	<b>77,757.00</b>	<b>80,890.00</b>	<b>84,023.00</b>

#### TRANSFERTA E KUSHTEZUAR Funksion I Deleguar - DAMT

ne 000/leke

2024	2025	2026	2027
9,563.00	10,463.00	10,463.00	10,463.00

#### TE ARDHURA TE PLANIFIKUARA KESHILLI I QARKUT

ne 000/leke

2024	2025	2026	2027
27,737.00	27,817.00	27,897.00	27,987.00

#### TOTALI KESHILLI I QARKUT

2024	2025	2026	2027
113,340.00	116,037.00	119,250.00	122,473.00

\*Ndërkohë, në vitin 2024 kemi dhe një fond për projektin social, të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vlerën 8985.9 mijë lekë.

\*Gjithashtu po në vitin 2024 kemi dhe fondin prej 9044.7 mijë lekë, të transferuara nga donatori (BE) për rimbursimin e shpenzimeve të kryera paraprakisht nga fondet e Këshillit të Qarkut, për projektin e huaj CLLD(cultour).

Të dyja këto vlera i shtohen buxhetit të vitit 2024 duke e çuar në një vlerë prej **131370.6** mijë ALL lekë.

Kryetar i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RAPORT

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR  
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027

Grupi i Menaxhimit Strategjik i kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave mbështetur në legjislacionin në fuqi.

**Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur puna e GMS :**

- *Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligji nr.68 /2017“Për financat e vetqeverisjes vendore”*
- *Ligji nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018.“Për procedurat standarte të Programit Buxhetor afatmesëm te njësisve të vetëqeverisjes vendore”*
- *Udhëzimin e Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 3 date 28.02.2024 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”*
- *Vendimin e Këshillit të Qarkut nr.22 Date 22.12.2023 Mbi miratimin e tavaneve përfundimtare dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 për Këshillin e Qarkut”,*

Raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave është një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin financiar si dhe prioritetet strategjike të zhvillimit të Rajonit tonë.

**I. Organizimi i punës për hartimin e PBA –së 2025-2027**

**1. Ngritja e grupit të punës**

Me Urdhër të Kryetarit të Këshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 , mbështetur në programet dhe aktivitetet të miratuara në Këshillin e Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbështetet në kalendarin për hartimin e programit buxhetor afatmesëm miratuar me Vendim të Këshillit të Qarkut nr. 21 date 22.12.2023.

## 2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Në drejtimin e Kryetarit të GMS, grupi i punës ka punuar për planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 mbështetur ne:

- Mundësitë reale të realizimit të burimeve të të ardhurave, si kusht për financimin e shpenzimeve.
- Analizën e realizimit të buxhetit në dy vitet paraardhëse si dhe në planifikimin aktiviteteve dhe programeve në Buxhetin e vitit 2024.
- Aktivitetet dhe Programet e miratuara në Programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 i miratuar me Vendim të Këshillit të Qarkut nr. 22 datë 22.12.2023, të lidhura me objektivat e zhvillimit të qeverisjes vendore.
- Ndarja e kuotave për transfertën e pakushtëzuar për PBA 2025-2027 do të bëhet mbi bazën e Udhëzimit nr 3 datë 28.02.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”
- Parashikimi i pritshëm i realizimit të kontratave për implementimin e Projekteve të fituara me fonde të Bashkimit Europian në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit ndërkufitar IPA CBC, si dhe fillimi i implementimit të projekteve të reja të Programit IPA 2021-2027.
- Normativat e lejuara të shpenzimeve të miratuara me akte ligjore e nënligjore.

**Tabela e realizimit të të ardhurave sipas programeve për periudhën 2022-2024**

Në 000/ lekë

Programi	Emërtimi i të Ardhurave	Fakti 2022	Fakti 2023	Plani 2024
01110	Transferta e pakushtëzuar	58691	71925	76040
01110	Të ardhurat e veta	2227	2090	27737
01110	Të ardhurat e trashëguara	64953	69731	45793
01160	Transferta e kushtëzuar	6423	8713	9563
		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Të ardhura gjithsej</b>	<b>132294</b>	<b>152459</b>	<b>159133</b>

- Në planifikimin e taveve përgatitore të të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, grupi i punës është mbështetur në nivelet e planifikimit të të ardhurave të miratuara në PBA 2024-2026 me Vendim të Këshillit të Qarkut nr. 22 dt. 22.12.2023, duke marrë parasysh edhe faktin e realizimit të të ardhurave për vitin 2023, trendin e realizimit të tyre, si dhe Udhëzimin nr 3 datë 28.02.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”

**Tabela e planifikimit të taveve të të ardhurave për periudhën 2025-2027**

Në 000/ lekë

Programi	Emërtimi i të Ardhurave	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026	Plan 2027
	Transferta e pakushtëzuar	<b>76040</b>	<b>77757</b>	<b>80890</b>	<b>84023</b>
	Të ardhurat e veta	<b>27737</b>	<b>27817</b>	<b>27897</b>	<b>27987</b>
	Transferta e kushtëzuar	<b>9563</b>	<b>10463</b>	<b>10463</b>	<b>10463</b>
	<b>Të ardhura gjithsej</b>	<b>113340</b>	<b>116037</b>	<b>119250</b>	<b>122473</b>

*\*Ndërkohë, në vitin 2024 kemi dhe një fond për projektin social, të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vlerën 8985.9 mijë lekë.*

*\*Gjithashtu po në vitin 2024 kemi dhe fondin prej 9044.7 mijë lekë, të transferuara nga donatori (BE) për rirabursimin e shpenzimeve të kryera paraprakisht nga fondet e Këshillit të Qarkut, për projektin e huaj CLLD(cultural).*

*Të dyja këto vlera i shtohen buxhetit të vitit 2024 duke e çuar në një vlerë prej 131370.6 mije lekë.*

Mbështetur në parashikimin e transfertës së pakushtëzuar sipas Udhezimit nr 3 datë 28.02.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027”, transfertat e pakushtëzuar është planifikuar përkatesisht për vitin 2025 2.3% më e lartë krahasuar me vitin 2024. Për vitin 2026 me 4% krahasuar me vitin 2025, dhe për vitin 2027 me 3.9% krahasuar me vitin 2026. Mendojmë se kjo është një rritje relativisht e mirë duke patur parasysh aktivitetet dhe programet e parashikuara për këtë Program Buxhetor Afatmesëm si dhe niveli i ulët i të ardhurave që realizon Këshilli i Qarkut. Transferta e pakushtëzuar kap rreth 70 % të buxhetit në total.

Lidhur me planifikimin e transfertës së kushtëzuar (fondet e deleguara për DAMT në qark) grupi i punës, duke patur parasysh edhe aktivitetin e kësaj drejtorie, nivelin e ritjes së transfertës së pakushtëzuar në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, propozon që ritja e këtij treguesi për vitin 2025 të jetë në të njëjtin nivel me ritjen që pësoi në vitin 2024. Fondi i DAMT-së është vetëm për pagesën e pagave, sigurimeve dhe shpenzimeve operative. Nga eksperiencia e viteve të mëparshme, shpenzimet operative kanë qënë të pandryshuara. Kjo do të thotë që kjo ritje lidhet me fondin e pagave. Duke u bazuar edhe në ritjen e fondit të pagave nga transfertat e pakushtëzuar, e cila është ritur në vitin 2025 dhe më pas është konstante për vitet 2026 dhe 2027, GMS gjykoj që edhe për transfertën e kushtëzuar të ndiqet e njëjta logjikë, duke lënë vitin 2026 dhe 2027 në të njëjtat nivele me vitin 2025.

Për sa i përket të ardhurave të veta. Këshilli i Qarkut realizon të ardhura vetëm nga kontributet e bashkive si dhe nga tarifat që aplikon DAMT-ja dhe shumë rrallë nga tarifat e urbanistikës.

Lidhur me planifikimin e të ardhurave të vetë institucionit, grupi i punës mori në analize realizimin e tyre në tre vitet paraardhëse dhe gjithashtu ndoqi një logjikë tjetër në lidhje me të ardhurat e realizuara nga kontributet e Bashkive. Duke qënë se ky tregues ka pasur një realizim shumë të ulët në vitet e mëparshme, GMS-ja propozoi ndryshimin e strategjisë për mbledhjen e tyre. Në varësi të kontributeve që Bashkitë do të derdhnin në Qark, do të jetë edhe financimi i Qarkut për Bashkitë, për projekte apo investime që ato do të paraqesin kryesisht në turizëm apo fusha të tjera të rëndësishme dhe që i shërbejnë zhvillimit të komplet Rajonit tonë. Kjo mund të jetë një mënyrë për të ritur kontributet e bashkive për llogari të Qarkut. Gjithashtu kjo është edhe arsyeja që në vitin 2024 parashikimi i të ardhurave është shumë më i lartë krahasuar me vitin 2023. Madje Këshilli i Qarkut miratoi edhe një ritje në të ardhurat e parashikuara për tu realizuar nga kontributet e bashkive në vlerën prej 4307000 leke, të cilat do të shtohen buxhetit 2024 të miratuar në muajin Dhjetor 2023. Kjo ritje u bë nisur nga propozimet e bashkive dhe gadishmeria e tyre për të derdhur kontributet e tyre për llogari të qarkut, në mënyrë që të perfitojnë realizimin e projekteve të investimeve sipas propozimeve të tyre. Konkretisht 27737 mijë lekë të ndara 27307 mijë lekë priten të realizohen nga kontributet e Bashkive, dhe 430 mije lekë nga të ardhurat që arkëtojnë Qarku nga tarifat e DAMT-së dhe shumë rrallë nga urbanistika. Të ardhurat nga tarifat, nga viti në vit kanë pasur trend rënës, si rrjedhojë edhe parashikimi për të do të ecë mbi bazën e realizimit të viteve të kaluara, pasi për vetë natyrën që kanë nuk mund të parashikohen. Për vitet 2024, 2025, 2026, 2027, të ardhurat e veta në total janë më të larta për shkak të parashikimeve optimiste të kontributeve të bashkive, por të ardhurat nga tarifat janë më të ulëta se vitet e mëparshme dhe se tavanet e miratuara në mbledhjen e muajit Dhjetor 2023, për arsyet e sipërpërmendura.

Pjesë e diskutimit ishin edhe projekt idetë për aktivitetet që do të parashikohen në vitet në vazhdim me synim arritjen e objektivave të Këshillit të Qarkut. Planifikimi i tavanëve të të ardhurave për tre vitet e ardhshme do të shërbejë si tregues kryesor dhe do të garantojë planifikimin e shpenzimeve sipas programeve dhe aktiviteteve në përmbushje të objektivave të Këshillit të Qarkut, kjo e lidhur edhe me Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 përfundimtar të miratuar në Këshillin e Qarkut në Dhjetor 2023.

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut të cilat janë marë në konsideratë në hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm janë si më poshtë:

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçë.*
- *Pjesëmarrja në Programet ndërkufitare e me gjerë dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njësive të qeverisjes vendore të Rajonit, si dhe bashkëpunimin ndërrajonal.*
- *Përmirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integritetit Europian.*
- *Fokusimi te projektet me impakt rajonal, në ato fusha ku vetë Rajoni ka nevojë për zhvillim.*

Në përfundim parashikimi i tavanëve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, që do të shërbejnë për procesin e planifikimit të shpenzimeve, është si më poshtë:

Per vitin 2025	116037 mijë lekë
Per vitin 2026	119250 mijë lekë
Per vitin 2027	122473 mijë lekë

### Grupi i Menaxhimit Strategjik

Kryetar i Këshillit të Qarkut - ERJON NEXHIPI  
Nënkryetar – MIMOZA SHULI  
Përgjegjës i Financës – OLJONA BEQIRAJ  
Shef i Kabinetit, Këshilltar Juridik – GJERGJI KRISTO  
Këshilltare për Projektet e Bashkimit Europian – MARIELA ALICKOLLI  
Specialist për Urbanistikën e Mbrojtjen e territorit - FLODI MERO  
Specialist për Shërbimet e Burimet Njerëzore – REDIN LATOLLARI  
Specialiste për shëndetësinë dhe çështjet sociale, arsimin dhe kulturën – PAOLA LARA  
Specialiste për programet e zhvillimit – ELONA MANO